



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

VLORE

Nr. 1134 Prot, datë 10.04.2025



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

TIRANË

Nr. 1484 Prot, datë 10.04.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI (KUADËR)

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

DHE

AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA, TIRANË

PËR NXITJEN E SHKËMBIMIT TË SHUMANSHËM, NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT
INSTITUCIONAL

Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë, i përfaqësuar nga Rektori **Prof. Dr. Aurela SALIAJ** dhe Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë, e përfaqësuar nga Komandanti/Rektori **Gjeneral brigade Bardhyl NUREDINAJ**, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë (UNIVLORA) dhe Akademisë së Forcave të Armatosura, Tiranë (AFA), në kuadër të zhvillimit të procesit të arsimit dhe kërkimit shkencor ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Neni 2

Baza ligjore

Zhvillimi i këtij bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.02.2020, "Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj".

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet UNIVLORA dhe AFA do të përfshijë veprimtaritë, si më poshtë vijon:
 - a. shkëmbimin dhe bashkëpunimin e pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë në kuadrin e veprimtarisë së mësimdhënies, hulumtimit dhe kërkimit shkencor;
 - b. shkëmbimin e studentëve në tri ciklet e studimit: Bachelor, Master dhe Doktoratë;
 - c. zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e kualifikimit dhe promovimin e kërkimit shkencor, duke organizuar seminare, konferenca dhe botime për thellimin e kërkimit shkencor, në fusha me interes të përbashkët;
 - d. realizimin e projekteve kërkimore dhe inovative të përbashkëta, me financim nga burime të ndryshme, përfshirë BE-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes, duke shkëmbyer informacion dhe ekspertizë në këto fusha;
 - e. nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e programeve të studimit të përbashkëta;
 - f. përdorimin e infrastrukturës mësimore, literaturës shkencore dhe sigurimin e bazës materiale dhe didaktike në funksion të procesit mësimor;
 - g. realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale (internship-e).
 - h. zhvillimin e veprimtarisë promovuese, ofrimin e bursave për studentët e programeve të përbashkëta të studimit.
2. UNIVLORA dhe AFA bien dakord që realizimi i veprimtarive në fushat e mësipërme (neni 3, pika a-h) do të realizohet në varësi të burimeve të disponueshme nga secili institucion.
3. Për fusha të veçanta do të hartohet aneks-marrëveshje specifike, e nënshkruar nga rektorët e dy institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 4

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, mosmarrëveshjes të punës, “fuqisë madhore” ose shkaqeve të tjera objektive, nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

Neni 5

Mirëbesimi

UNIVLORA dhe AFA do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë. Palët duhet të ruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë marrëveshje.

Neni 6

Ndryshimi

Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet UNIVLORA dhe AFA.

Neni 7

Afati dhe vlefshmëria

Marrëveshja është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit të saj dhe rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur.

Nëse njëri prej rektorëve dëshiron të ndërpresë këtë Marrëveshje, ai duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër jo më pak se 3 (tre) muaj para përfundimit të periudhës, përmes një komunikimi zyrtar.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga dy rektorët si dhe miratimit nga organet kolegjiale respektive.


Marrëveshja hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe. Të dy tekstet e saj janë autentike.

Palët nënshkruese

Rektori

i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë

Prof. Dr. Aurela SALIAJ



Komandanti / Rektori

i Akademisë së Forcave të Armatosura, Tiranë

Gjeneral brigade Bardhyl NUREDINAJ

